

Në përgjigje të kërkesës, ju informojmë se:

Buxheti i rimbursimit të barnave për vitin 2023 jepet sipas Ligjit Nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, neni 5: “Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk tejkalon tavanin prej 11.400 milionë lekësh”. Fondi financon Listën e Barnave të Rimbursueshme të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 489, datë 30.07.2021, “Për miratimin e Listës së Barnave që rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, dhe të masës së mbulimit të çmimit të tyre”, të ndryshuar.

Barnat e kësaj VKM janë të ndara në dy lista: Lista e barnave që tregtohen në farmacite e rrjetit të hapur dhe lista e barnave që tregëtohen në farmacinë Qendrore të QSUT-së/spitaleve rajonale/bashkiake.

Kjo listë është konceptuar në bazë të klasifikimit të Sistemit ATC (anatomik, terapeutik dhe kimik).

Në Grupin e Barnave antineoplazike dhe imunosupresore janë të përfshira barnat L01 antineoplazike si: Lomustine 40 mg, Temozolomide 100 mg dhe 250 mg, Capecitabine 150mg dhe 500 mg, Alectinib Hydrochloride 150 mg, Rituximab 1400 mg, Trastuzumab 600mg / 5 ml, Pembrolizumab 25mg/ml - 4ml, Sunitinib 50 mg, Sunitinib 12.5 mg dhe 25mg, Sorafenib 200 mg, Nilotinib 150 mg, Pazopanib 400 mg, Vemurafenib 240mg, Ruxolitinib 20 mg, Dabrafenib 75 mg, Trametinib 2 mg, Ibutinib 140 mg, Palbociclib 125 mg, Palbociclib 75 mg, Palbociclib 100 mg, Ribociclib 200 mg, Imatinib 100 mg, Methotrexate 2.5 mg, Fludarabine 10 mg, Hydroxycarbamide 500 mg.

Të gjithë këto barna përfitohen me rimbursim 100 % nga pacienti. Rimbursimi i këtyre medikamenteve është pjesë e buxhetit të rimbursimit miratuar me Ligjin Nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, neni 5 (cituar më lart).